



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
KËSHILLI I MINISTRAVE



AKT NORMATIV

Nr. 25, datë 22.6.2021

PËR

**DISA NDRYSHIME DHE SHTESA NË LIGJIN NR.9936,
DATË 26.6.2008, "PËR MENAXHIMIN E SISTEMIT BUXHETOR
NË REPUBLIKËN E SHQIPËRISË", TË NDRYSHUAR**

Në mbështetje të nenit 101 të Kushtetutës, me propozimin e ministrit të Financave dhe Ekonomisë, Këshilli i Ministrave

V E N D O S I:

Në ligjin nr.9936, datë 26.6.2008, "Për menaxhimin e sistemit buxhetor në Republikën e Shqipërisë", të ndryshuar, bëhen këto ndryshime dhe shtesa:

Neni 1

Në pikën 5, të nenit 4/1, fjalët "... vitit buxhetor 2023 ..." zëvendësohen me "... vitit buxhetor 2024 ...".

Neni 2

Në fund të nenit 74, "Dispozita kalimtare", shtohet një paragraf, me këtë përmbajtje:

"Përjashtimisht, për vitin 2021, nuk zbatohen parimet dhe rregullat fiskale të përcaktuara në pikat 1, 2, 3 dhe 4, të nenit 4/1, të këtij ligji."

Neni 3

Ky akt normativ hyn në fuqi menjëherë dhe botohet në “Fletoren zyrtare”.

KRYEMINISTRI

EDI RAMA


Në mungesë dhe me porosi

ZËVENDËSKRYEMINISTRI

ERION BRAÇE

**MINISTRI I FINANCAVE
DHE EKONOMISË**

ANILA DENAJ



NR.PROT. 3049/1
DATË 23.6. 2021

KUVENDIT
MINISTRISË SË FINANCAVE DHE EKONOMISË
QENDRËS SË BOTIMEVE ZYRTARE

Sekretari i Përgjithshëm

Engjell AGACI

